



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 54/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit me elemente të fushatës zgjedhore, në rrugë publike para kohës së caktuar për fushatë zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme që do të mbahen më 08.06.2014, në seancën e panelit të mbajtur me 13.05.2014, mori këtë:

## V E N D I M

**HIDHET** poshtë si e palejuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosja (LVV).

### Arsyetim

PZAP-i, me datë 12.05.2014, ka pranuar një ankesë nga LVV dega në Prishtinë, me të cilin thekson se aktivistët e saj kanë vërejtur se në udhëkryqin tek mensa e studentëve konkretisht tek kryqëzimi i rrugëve Agim Ramadani dhe Xheladin Rekaliiu mbi rrugë publike është vendosur poster i PDK-së. Parashtruesi i ankesës thekson se ky poster është pjesë e fushatës së fundit të proklamuar nga ky subjekt politik dhe se me këtë rast sipas palës ankuese subjekti politik PDK me këtë veprim ka bërë shkelje të rregullës zgjedhore 11/2013.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi disa fotografi nga vendi i ngjarjes për të cilat pretendohet në ankesë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

**ankesa është e palejuar**

Sipas Nenit 33 dhe 44 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013, *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët* dhe Rregulla Zgjedhore Nr. 13/2013 *Fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike*, përcaktojnë aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore ku ndalojnë veprimet e subjekteve politike, mbështetësve të tyre ose kandidatët e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

Periudha për fillimin e fushatës zgjedhore e përcaktuar nga KQZ-ja, për zgjedhjet e parakohshme parlamentare fillon nga data 28.05.2014 dhe zgjat deri më datën 06.06.2014, andaj duke u bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore, me të cilën përcaktohen veprimet e ndaluara të subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore si dhe duke pasur parasysh se pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë nga pala ankuese janë zhvilluar para datës zyrtare të caktuar për fushatë zgjedhore PZAP-i, konstaton se ankesa në fjalë është e palejuar ngase për veprimet e tilla as me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme e as me Rregullat Zgjedhore nuk është paraparë sanksionimi apo marrja e masave tjera ndëshkimore.

Prandaj duke u bazuar në arsyet e lartpërmendura dhe në dispozitat e nenit 33 dhe nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 54/2014 më datën 13.05.2014.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Hasan Shala**



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5.000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*